



INSTITUCIONI I OMBUDSPERSONIT në KOSOVË
INSTITUCIJA OMBUDSPERSONA na KOSOVU
OMBUDSPERSON INSTITUTION in KOSOVO

Adresa: Rr. Agim Ramadani (Ish ndërtesa "Kosovodrvo"), 10000 Prishtinë, **KOSOVA**
Adresa: Ul. Agim Ramadani (Bivša zgrada "Kosovodrvo"), 10000 Prishtina, **KOSOVO**
Address: Agim Ramadani Str. (Ex "Kosovodrvo" building), 10000 Pristina, **KOSOVO**
Tel: ++381 (0) 38 501 401, 545 303, 540 447, 548 087, Fax: ++381 (0) 38 545 302
e-mail: ombudspersonkosovo@ombudspersonkosovo.org
web site: www.ombudspersonkosovo.org

Më 5 korrik 2007,

Z. Agim Çeku
Kryeministër i Kosovës

KËRKESË
URGJENTE PËR MASË TË PËRKOHSHME

Ex-officio nr. 011/2007

Lidhur me Memorandumin e mirëkuptimit mes Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Ministrisë së Punëve të Breshme dhe Korporatës Energjetike të Kosovës(KEK) mbi kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me pagesën e faturave të energjisë elektrike

I nderuari z. Çeku,

Unë kam vendosur që të hap hetimet zyrtare pas informacioneve të publikuara në mjetet e informimit publik lidhur me nënshkrimin e Memorandumit të mirëkuptimit mes Ministrisë së Energjisë dhe Minierave, Ministrisë së Punëve të Breshme dhe Korporatës Energjetike të Kosovës(KEK), në bazë të të cilit parashihet të bëhet kushtëzimi i regjistrimit të automjeteve të qytetarëve me pagesën e faturave të energjisë elektrike.

Memorandumi i lartpërmendur ngritë çështje serioze lidhur me mungesën e bazës ligjore për një vendim të tillë si dhe krijon mundësinë e shkakimit të pasojave të pariparueshme si dhe përfshin numër të madh të njerëzve që do të mund t'i nënshtroheshin pasojave të një vendimi të tillë.

Në bazë të ligjit të aplikueshëm në Kosovë, nuk ekziston ndonjë dispozitë ligjore që lejon marrjen e ndonjë vendimi në bazë të të cilit qytetarëve u kushtëzohet regjistrimi i automjeteve me sjelljen e

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!

dëshmime për pagesën e borxheve të tyre ndaj KEK-ut apo kujtdo qoftë tjetër. Nga kjo mund të përfundojmë se memorandumit në fjalë është i paligjshëm.

Marrja e vendimeve të pa bazuara në ligj është në kundërshtim me nevojën për një qeverisje të drejtë dhe me respektimin e të drejtave të njeriut e që do të duhej të jetë detyrë e çdo administrate civile. Për më tepër, shqetësimet janë edhe më të mëdha nëse vendimet e tilla nxirren nga vet administrata civile.

Duke konsideruar atë që u tha më lartë, kërkoj që çështjes në fjalë t'i kushtoni vëmendje të merituar dhe të ndihmoni në eliminimin e parregullësive dhe rivendosjen e rendit dhe ligjit si parakusht për funksionimin e shtetit ligjor dhe sistemit demokratik, për çka jam i bindur se është qëllimi ynë i përbashkët.

Në këtë drejtim, në pajtim me kompetencat e mia sipas neneve 4.7 dhe 4.10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/6 mbi Institucionin e Ombudspersonit në Kosovë si dhe Regullës 10.2 dhe 10.3 të Regullave procedurale, kërkoj nga ju që të ndërmerrni hapa urgjentë për të siguruar që të suspendohet zbatimi i memorandumit të tillë deri në përfundimin e hetimeve të mia lidhur me këtë çështje dhe të më siguronit një kopje të vendimit tuaj.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Ushtrues i Detyrës së Ombudspersonit

kopja u dërgohet: z. Joachim Rücker, Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm
z. Ethem Çeku, Ministër i Ministrisë së Energjisë dhe Minierave
z. Jonuz Salihaj, Ministër i Drejtësisë
z. Blerim Kuqi, Ministër i Punëve të Brendshme

pdfMachine

Is a pdf writer that produces quality PDF files with ease!

Produce quality PDF files in seconds and preserve the integrity of your original documents. Compatible across nearly all Windows platforms, if you can print from a windows application you can use pdfMachine.

Get yours now!